

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR

“TIPOGRAFI”

Kodi: PK-P-1-22

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“TIPOGRAFI”

(PK-P-1-22)

I. Profili Profesional i tipografit

a) *Karakteristikat e tipografit*

Tipografia është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar në ndërmarrje/reparte të tipografisë (shtypshkëtit) ku kryen detyra që kanë të bëjnë me shtypjen e librave, revistave, gazetave dhe produkteve të tjera të tipografisë.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, tipografia duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të tipografisë.

Suksesi i tipografit është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) *Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e tipografit*

Profesioni i tipografit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës të parapërgatitjes për shtyp, shtypjes, libërlidhjes dhe punimeve përfundimtare të shtypit. Ai mund të punësohet në ndërmarrje të tipografisë fillimisht si ndihmës tipograf. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë, tipografia mund të përparojë profesionalisht në nivelin e tipografit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale, trajnimin në qendra të formimit profesional apo nëpërmjet punës, një tipograf mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i tipografisë.

Për të zhvilluar aktivitet privat në fushën e tipografisë, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Tipograf”, me kod 7321.20, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Tipografi

Në përfundin të Kursit për Tipografi, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik të tipografisë.
- Realizojnë organizimin e vogël të punës në repartin e tipografisë.
- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, instrumentat, makineritë dhe materialet e duhura të punës.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës.
- Kryejnë matje dhe kontrole që lidhen me punimet e tipografisë.
- Realizojnë procedurat e prerjes së letrës.
- Realizojnë procedurat e larjeve, ujë etj.
- Realizojnë procedurat e ngarkimit të makinës.
- Realizojnë procedurat e vendosjes dhe heqjes së lastrës.
- Realizojnë procedurat e furnizimit me bojë, solucione.
- Realizojnë procedurat e shtypjes.
- Realizojnë procedurat e palosjes.

- Realizojnë procedurat e mbledhjes.
- Realizojnë procedurat e qepjes.
- Realizojnë procedurat e ngjitjes.
- Realizojnë procedurat e prerjes së librit.
- Realizojnë procedurat e prerjes së librit.
- Realizojnë procedurat e kontrollit të librit.
- Realizojnë procedurat e paketimit dhe ambalazhimit
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me punimet dhe produktet e tipografisë.
- Plotësojnë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimet dhe produktet e tipografisë.
- Zbatojnë standardet e profesionit të tipografit.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të tipografisë.
- Komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për Tipografi.

Pjesmarrësit në Kursin për Tipografi duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për Tipografi

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për Tipografi

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e tipografit	MK-22-328-22	60 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të tipografit. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet, materialet dhe produktet e tipografisë. 3. Kursanti përshkruan proceset teknologjike të tipografisë. 4. Kursanti përdor dokumentacionin teknik dhe financiar të tipografisë. 5. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në tipografi
2	Shtypja	MK-22-329-22	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përgatit letrën për shtyp. 2. Kursanti përgatit makinën për shtyp. 3. Kursanti kryen shtypjen e fashikujve.

3	Libërlidhja	MK-22-330-22	110 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti palos letrën e shtypur 2. Kursanti qep fashikujt 3. Kursanti preson fashikujt 4. Kursanti ngjit fashikujt e presuar 5. Kursanti vendos kopertinën e shtypur në libër
4	Punimet përfundimtare të shtypit	MK-22-331-22	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti kryen procesin e prerjes së librave. 2. Kursanti kryen kontrollin e cilësisë së librave 3. Kursanti kryen ambalazhimin e librave

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Tipografi:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e tipografit”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E TIPOGRAFIT	MK-22-328-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të tipografit, me mjedisin, mjetet, materialet dhe produktet e tipografisë, me dokumentacionin teknik përkatës, me rregullat për mbrojtjen në punë dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së punimeve në tipografi.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të tipografit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të argumentojë rolin e tipografisë në shoqërinë dhe ekonominë e sotme.- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së tipografit.- të përshkruajë kërkesat profesionale për tipografin.- të tregojë mundësitë e punësimit të tipografit.- të tregojë mundësitë e shkollimit dhe të karrierës profesionale të tipografit.- të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.- të përshkruajë kuadrin ligjor bazë që vepron në sektorin e tipografisë.- të shpjegojë zbatimin e kodit të punës dhe kërkesat ligjore për hapjen dhe veprimtarinë e bizneseve që veprojnë në fushën e tipografisë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë.- Pyetje - përgjigje me shkrim. <p>RN 2 Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet, materialet dhe produktet e tipografisë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe pajisjen e një reparti të tipografisë.- të përshkruajë organizimin e punës në një repart të tipografisë.	

- të dallojë dhe përshkruajë makineritë që përdoren në një repart të tipografisë.
- të dallojë dhe përshkruajë pajisjet që përdoren në një repart të tipografisë.
- të dallojë dhe përshkruajë veglat dhe instrumentat që përdoren në një repart të tipografisë.
- të dallojë dhe përshkruajë materialet (lëndët e para) që përdoren në një repart të tipografisë.
- të dallojë dhe përshkruajë lëndët e ndihmëse që përdoren në një repart të tipografisë.
- të dallojë dhe përshkruajë produktet kryesore të tipografisë (librat, revistat, gazetat etj.).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti përshkruan proceset teknologjike të tipografisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë ecurinë historike dhe evoluimin e teknologjisë së tipografisë.
- të përshkruajë konceptet dhe parimet kryesore që lidhen me teknologjinë e tipografisë.
- të përshkruajë proceset teknologjike që kryhen në një repart tipik të tipografisë.
- të shpjegojë bllok-skemat e makinave bazë të tipografisë.
- të tregojë proceset teknologjike që kryhen në makinat bazë të tipografisë.
- të shpjegojë mënyrat dhe teknologjitë e ndryshme që përdoren sot në fushën e tipografisë.
- të argumentojë rëndësinë dhe impaktin e automatizimit dhe të digjitalizimit në teknologjinë e tipografisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë;
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RN 4 Kursanti përdor dokumentacionin teknik dhe financiar të tipografisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të argumentojë rëndësinë e dokumentacionit teknik dhe financiar të tipografisë.
- të interpretojë kartën teknologjike për punime të ndryshme të tipografisë.
- të shpjegojë simbolet dhe procedurat e kartës teknologjike të punimeve të tipografisë.
- të interpretojë dhe plotësojë formatet e dokumentacionit teknik të tipografisë.
- të shpjegojë standardet ndërkombëtare për punimet e tipografisë.
- të përshkruajë zërat që konsiderohen për llogaritjen e kostos

- dhe çmimit në veprimtarinë dhe produktet e tipografisë.
- të interpretojë dhe plotësojë dokumentacionin (faturat) financiar për punimet dhe produktet e tipografisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në tipografi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të ruajtjes së personit në punë gjatë punimeve në tipografi.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes në mjediset e punës së tipografisë.
- të listojë rreziqet gjatë kryerjes së punimeve të tipografisë
- të shpjegojë masat për shmangien e rreziqeve gjatë punimeve të tipografisë.
- të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm.
- të shpjegojë rëndësinë, përbërjen dhe përdorimin e kutisë së ndihmës së parë.
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e plagosjeve.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga rryma elektrike.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga zjarri në repartin e tipografisë.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga veprimi i kimikateve në repartin e tipografisë.
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes dhe magazinimit të produkteve, lëndëve të para dhe ndihmëse të tipografisë.
- të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit në tipografi.
- të përshkruajë masat për shmangien e ndotjes së mjedisit në punimet e tipografisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së repartit të tipografisë. Rekomandohen dhe vizita e praktikim në mjediset e punës së bizneseve të tipografisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin tipografisë. Atyre duhet t'i jepen detyra të ndryshme në lidhje me çështjet që trajtohen në modul. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat

që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë dhe kryejnë.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Reparte të punës së tipografisë të pajisur me mjetet e punës.
 - Materiale dhe produkte të tipografisë.
 - Karta teknologjike
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filma etj.) për konkretizimin e njohurive
-

2. Moduli “Shtypja“

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHTYPJA	MK-22-329-22
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët për të kryer punimet e parapërgatitjes së letrës dhe të makinës për shtyp, dhe për të realizuar shtypjen e fashikujve.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e tipografit”.	
Rezultatet e të Nxënërit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përgatit letrën për shtyp. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përgatitë vendin e punës.- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.- të përcaktojë drejt rradhën e punës për përgatitjen e letrës.- të përzgjedhë drejt llojin e letrës sipas kartës teknologjike.- të përgatitë thikën prerëse për prerjen e letrës.- të vendosë përmasat e kërkuara për prerjen e letrës.- të përcaktojë numrin e duhur të fletëve të letrës.- të vendosë pakon e letrës në thikë.- të presë sasinë e kërkuar të letrës.- të heqë dhe sistemojë letrën e prerë.- të largojë mbetjet e prerjes.- të kryejë matje të sakta.- të bëjë kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.- të zbatojë standardet e tipografisë.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për përgatitjen e letrës për shtyp. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti përgatit makinën për shtyp. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të përgatitë vendin e punës.- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.- të përcaktojë drejt rradhën e punës për përgatitjen e makinës për shtyp.- të përzgjedhë materialet dhe solucionet e duhura.- të bëjë larjen e makinës.- të bëjë vendosjen e duhur të lastrës së parë.	

- të bëjë furnizimin me bojë të makinës.
- të bëjë furnizimin me ujë ose ujë + alkool të makinës.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera.
- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë standardet e tipografisë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së makinës për shtyp.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti kryen shtypjen e fashikujve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatitë vendin e punës.
- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për shtypjen e fashikujve.
- të përzgjedhë materialet dhe solucionet e duhura.
- të përzgjedhë dhe sistemojë letrat (fashikujt) që do të shtypen.
- të vendosë makinën në punë.
- të vendosë letrën në makinë.
- të bëjë nxjerrjen e letrës së parë të shtypur.
- të kontrollojë saktësinë dhe cilësinë e shtypit të letra e parë.
- të bëjë korigjimin e masës së shtypit nëpërmjet atrecimit të makinës.
- të bëjë rregullimin e sasisë së bojës së shtypit, të makina.
- të vijojë shtypjen e fashikujve nga njëra anë, sipas tirazhit të përcaktuar të karta teknologjike e punimit.
- të bëjë heqjen dhe sistemimin e fashikujve të shtypur nga njëra anë.
- të bëjë ndërrimin e lastrave për shtypjen e fashikujve nga ana tjetër.
- të përshtatë (atrecojë) makinë për shtypjen e fashikujve nga ana tjetër.
- të vijojë me procedurën e shtypjes së fashikujve nga ana tjetër.
- të heqë dhe sistemojë fashikujt e shtypur.
- të mbikqyrë ecurinë dhe cilësinë e shtypjes së fashikujve.
- të bëjë furnizimin me ujë ose ujë + alkool të makinës, nëse është e nevojshme.
- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë standardet e tipografisë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të shtypjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës së repartit të tipografisë.
- Rekomandohen edhe vizita dhe praktikim në mjedise pune të bizneseve të tipografisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara dhe demonstrime konkrete të punimeve që kryhen.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin tipografisë për përgatitjen e letrës dhe të makinës për shtyp, dhe për shtypjen e fashikujve. Atyre duhet tu jepen detyra praktike për punimet që përmban moduli, si dhe të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Reparte të punës së tipografisë të pajisur me makinat dhe mjetet e punës.
 - Materiale dhe produkte të tipografisë.
 - Letra të llojeve e parametrave të ndryshëm.
 - Lastrat dhe solucionet e duhura për furnizimin e makinës së shtypit.
 - Karta teknologjike.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Libërlidhja“

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	LIBËRLIDHJA	MK-22-330-22
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët për të kryer procedurat e palosjes së letrës së shtypur, të qepjes, presimit dhe ngjites së fashikujve, si dhe të vendosjes së kopertinës së shtypur në libër.	
Kohëzgjatja e modulit	110 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e tipografit”.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti palos letrën e shtypur. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përgatitë vendin e punës.- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.- të përcaktojë drejt rradhën e punës për palosjen e letrës së shtypur.- të përgatitë makinën e palosjes së letrës.- të përzgjedhë letrën e shtypur.- të vendosë letrën e shtypur në makinë.- të vendosë në funksionim makinën e palosjes.- të palosë fashikujt.- të mbledhë fashikujt.- të sistemojë fashikujt e palosur.- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.- të bëjë kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera.- të zbatojë standardet e tipografisë.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për palosjen e letrës së shtypur. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti qep fashikujt. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të përgatitë vendin e punës.- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.- të përcaktojë drejt rradhën e punës për qepjen e fashikujve.- të përzgjedhë fashikujt e palosur, që do të qepen.- të përzgjedhë gjilpërat, grapetat dhe penjtë e duhur.- të përgatitë makinën e qepjes.- të vendosë gjilpërat në makinë.- të vendosë grapetat.	

- të vendosë penjtë
- të vendosë fashikujt e mbledhur
- të vendosë në funksionim makinën e qepjes.
- të mbikqyrë procesin e qepjes së fashikujve.
- të heqë dhe sistemojë fashikujt e qepur.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera.
- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë standardet e tipografisë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për qepjen e fashikujve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti preson fashikujt.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatitë vendin e punës.
- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për presimin e fashikujve të qepur
- të përgatisë makinën (presën) për punë.
- të përzgjedhë fashikujt e qepur që do të presohen.
- të vendosë fashikujt e qepur në presë.
- të vendosë në funksionim presën.
- të mbikqyrë procesin e presimit të fashikujve.
- të heqë dhe sistemojë fashikujt e presuar.
- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera.
- të zbatojë standardet e tipografisë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të presimit të fashikujve të qepur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti ngjit fashikujt e presuar.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatitë vendin e punës.
- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për ngjiten e fashikujve të presuar.
- të përzgjedhë fashikujt e presuar që do të ngjiten.
- të përzgjedhë ngjitësin, furçën dhe materialet e nevojshme.
- të parapërgatitë ngjitësin.
- të vendosë fashikujt e presuar në bangon e punës për ngjitje.
- të kryejë lyerjen me ngjitës të fashikujve të presuar.
- të kryejë tharjen e fashikujve të lyer me ngjitës.

- të kryejë ndarjen e fashikujve në libra të veçantë.
- të sistemojë librat e ngjitur.
- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera.
- të zbatojë standardet e tipografisë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së makinës për shtyp.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Kursanti vendos kopertinën e shtypur në libër.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatitë vendin e punës.
- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për vendosjen në libra të kopertinave të shtypura.
- të për zgjedhë librat dhe kopertinat që do të vendosen në libra.
- të përgatitë makinën “binder” për ngjitjen e kopertinave.
- të bëjë furnizimin e makinës për ngjitjen e kopertinave.
- të regjistrojë makinën për ngjitjen e kopertinave.
- të vendosë kopertinat në makinë.
- të vendosë librat në makinë.
- të vendosë në funksionim makinën për ngjitjen e kopertinave.
- të kryejë ngjitjen e kopertinave me librat.
- të bëjë sistemimin e librave të ngjitur.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera.
- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë standardet e tipografisë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të vendosjes së kopertinave në libra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës së repartit të tipografisë.
- Rekomandohen edhe vizita dhe praktikim në mjedise pune të bizneseve të tipografisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara dhe demonstrime konkrete të punimeve që kryhen.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin tipografisë për palosjen e letrës së shtypur, qepjen, presimin dhe ngjitjen e fashikujve, si dhe për vendosjen e kopertinës së shtypur në libër. Atyre duhet tu jepen detyra praktike për punimet që përmban moduli, si dhe të nxiten

që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Reparte të punës së tipografisë të pajisur me makinat dhe mjetet e punës.
 - Materiale dhe produkte të tipografisë për libërlidhjen.
 - Letra të llojeve e parametrave të ndryshëm.
 - Materialet e nevojshëm për të realizuar libërlidhjen (ngjitësa, gjilpëra, grapeta, penjë).
 - Karta teknologjike të tipografisë.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Punimet përfundimtare të shtypit“

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIMET PËRFUNDIMTARE TË SHTYPIT	MK-22-331-22
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët për të kryer procedurat përfundimtare të shtypit (prerjen, kontrollin e cilësisë dhe ambalazhimin e librave).	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e tipografit”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti kryen procesin e prerjes së librave. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përgatitë vendin e punës.- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.- të përcaktojë drejt rradhën e punës për prerjen e librave.- të përzgjedhë librat që do të priten.- të bëjë parapërgatitjen e makinës prerëse (njëanëshe apo treanëshe).- të bëjnë regjistrimin e përmasave të duhura të makina prerëse e librave.- të vendosë librat në makinën prerëse.- të vendosë në funksionim makinën për prerjen e librave.- të kryejë prerjen e librave.- të bëjë heqjen dhe sistemimin e librave të prerë.- të largojë mbetjet e prerjes së librave.- të kryejë matje të sakta.- të bëjë kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera.- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.- të zbatojë standardet e tipografisë.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të prerjes së librave. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti kryen kontrollin e cilësisë së librave. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përgatitë vendin e punës.- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.- të përcaktojë drejt rradhën e punës për kontrollin e cilësisë së librave.- të përzgjedhë librat për të cilat do të bëhet kontrolli i cilësisë.	

- të përzgjedhë instrumentet matëse-kontrolluese të cilësisë së librave.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së shtypit të librat.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së dimensioneve të librave.
- të bëjë kontrollin e pastërtisë së librave.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së ngjyrave të librat.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së ngjytjes së librave.
- të bëjë kontrollin e cilësisë së prerjes së librave.
- të përdorë instrumentet matëse-kontrolluese të librave.
- të bëjë përmirësimet e duhura të cilësisë së librave.
- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë standardet e tipografisë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të cilësisë së librave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti kryen ambalazhimin e librave.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatitë vendin e punës për ambalazhimin e librave.
- të analizojë drejt kartën teknologjike të punimit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për ambalazhimin e librave.
- të përzgjedhë dhe vendosë në bangon e punës librat që do të ambalazhohen.
- të përzgjedhë materialet e duhura për ambalazhimin (paketimin, etiketimin).
- të bëjë numërimin e saktë të librave.
- të bëjë paketimin e librave.
- të bëjë etiketimin e librave.
- të bëjë sistemimin e librave të ambalazuara.
- të largojë mbetjet nga vendi i punës.
- të mirëmbajë mjedisin dhe mjetet e punës.
- të zbatojë standardet e tipografisë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të ambalazhimit të librave.
- të kryejë llogaritjet e financiare për kostot e punimeve të kryera.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimet e kryera.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës së repartit të tipografisë.
- Rekomandohen edhe vizita dhe praktikim në mjedise pune të bizneseve të tipografisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e

mundur shpjegimet të ilustruara dhe demonstrime konkrete të punimeve që kryhen.

- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin tipografisë për procedurat përfundimtare të shtypit (prerjen, kontrollin e cilësisë, ambalazhimin e librave dhe plotësimin e dokumentacionit teknik dhe financiar të punimeve të kryera). Atyre duhet tu jepen detyra praktike për punimet që përmban moduli, si dhe të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Reparte të punës së tipografisë të pajisur me pajisjet dhe mjetet e punës.
 - Materiale dhe produkte (libra) të tipografisë.
 - Materiale ambalazhimi dhe etiketimi.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar për punimet e tipografisë.
 - Karta teknologjike.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-